



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Avokati
i Popullit

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 42 380 300 / 315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. 844 Prot

Tiranë 15/11/2018

Lënda: Mbi dërgimin e kandidaturave për pozicionet e Komisionerëve pranë Avokatit të Popullit

Drejtuar: Z. Gramoz Ruçi
Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë ✓

Për dërgim: Z. Ulsi Manja
Kryetar i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

TIRANË

I nderuar z. Kryetar,

Në respekt të nenit 33/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, institucioni i Avokatit të Popullit, nëpërmjet thirrjes së hapur publike, ka njoftuar procesin e përzgjedhjes së kandidaturave për tre vendet vakante për Komisioner respektivisht:

- Komisioner në Seksionin e përgjithshëm
- Komisioner në Seksionin për policinë, shërbimin sekret, burgjet, Forcat e Armatosura dhe pushtetin gjyqësor;

- *Komisioner në Seksionin për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre;*

Brenda afatit të përcaktuar, u paraqitën 13 (trembëdhjetë) kandidatura të cilët u ftuan më datë **30.10.2018**, për të prezantuar platformën e tyre në seancën dëgjimore me Komisionin Ad-Hoc (një nga kandidatët nuk u paraqit në seancën dëgjimore). Në përbërje të këtij komisioni ishin përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, që veprojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, si dhe përfaqësues të institucionit të Avokatit të Popullit si më poshtë:

- Znj. Erinda Ballanca Avokat i Popullit
- Znj. Kledia Ngjela Këshilltar, Avokati i Popullit
- Znj. Mirela Arqimandriti Qendra Aleanca Gjimore për Zhvillim
- Znj. Ina Xhepa Qendra Europiane
- Z. Andi Bora Gazetar, Projekti Faktoje al

Kjo seancë dëgjimore ishte e hapur dhe u zhvillua në ambjentet e institucionit të Avokatit të Popullit ku kandidatët pjesëmarrës u vlerësuan në bazë të kushteve ligjore dhe kritereve objektive.

- vlerësimin e jetëshkrimit** të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën;
- vlerësimin e platformës** (prezantimi i kandidaturës, problematikat e fushës ku aplikohet, çështjet që duhet të trajtohen me përparësi, mënyrën e menaxhimit dhe drejtimit të seksionit/mekanizmit;
- vlerësimin e veprimtarisë** në mbrojtjen dhe nxitjen e respektimit të të drejtave dhe lirive të shtetasve;
- intervistën e strukturuar me gojë** (vlerësimin e jetëshkrimit, të njohurive, integritetit, figurës, aftësive dhe formimit të kandidatëve).

Në zbatim të nenit 33/1, pika 6, të ligjit të nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, në të cilin theksohet se: “Lista me katër kandidatët e përzgjedhur nga Avokati i Popullit për çdo vend vakant, së bashku me vlerësimin e tij për përmbushjen e kushteve ligjore dhe kritereve objektive dhe renditjen e kandidaturave sipas preferencës së tij, i kalon komisionit të Kuvendit që mbulon çështjet ligjore.....”, Avokati i Popullit vlerëson se kandidaturat e mëposhtme plotësojnë kushtet ligjore, duke i renditur sipas vlerësimit të kritereve objektive.

Avokati i Popullit gjithashtu dëshiron t’ju bëjë me dije se në përzgjedhjen e kandidaturave, mban parasysh dhe vlerësimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë në dhënien e

pëlqimit të tij gjatë votimit për zgjedhjen Komisioner, të kandidaturave të paraqitura gjatë vakancës së mëparëshme.

Në përfundim të këtij procesi Avokati i Popullit ka vendosur që t'i propozojë Kuvendit të Shqipërisë listën e kandidaturave si më poshtë:

I. Për pozicionin Komisioner në Seksionin e Përgjithshëm

- Znj.Vilma Shurdha
- Z.Andi Nano
- Znj.Ermonela Ruspi
- Znj.Aljona Mancaku

II. Për pozicionin Komisioner në Seksionin për Policinë, Shërbimin Sekret, Burgjet, Forcat e Armatosura dhe Pushtetin Gjyqësor

- Z.Arjan Hoxha
- Znj.Ermonela Ruspi
- Z.Illir Kadiu
- Z.Artan Ballabani

Për sa më sipër, gjithashtu ju informojmë se për kandidaturat në pozicionin Komisioner në Seksionin për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre, institucioni i Avokatit të Popullit ndodhet ende në pritje të përgjigjes verifikuese nga Autoriteti për Informim mbi dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, për një nga kandidaturat, e cila plotëson deri në këtë moment kushtet ligjore. Vlerësimi i kriterëve objektive për këtë kandidaturë do të vijojë pas përgjigjes nga Autoriteti, dhe menjëherë më pas Avokati i Popullit do të përcjellë kandidaturat dhe për këtë Seksion pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Me respekt

AVOKAT I POPULLIT
ERINDA BALLANCA

